

Emri i Lëndës : Metodatat e Kerkimit dhe Shkrim Akademik							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
CMP 305	A	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.50	6.00
Lektori		Arti Omeri, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik pohon se në të vërtetë me anë të këtij përcaktimi kuptohet një teori e nyjtuar, konceptet operative të së cilës përdoren për të nxënë njohuri që janë në funksion të zgjidhjeve të problemeve, të ndërtimit dhe përkufizimit të koncepteve për strategji zhvillimore, planifikim strategjik, për menaxhim efektiv. Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik ndihmojnë në përgatitjen e një punimi të mirë, që njëherazi mund të vlejë për të rifituar besimin në dobinë dhe vlerën përparimjellëse të të studiuarit, të kuptuar jo thjesht si grumbullim të dhënash, por si përpunim kritik i një përvoje, si fitim aftësie (të vlefshme për të ardhmen) për të zbuluar problemet, për t`i trajtuar në mënyrë metodike ato dhe për t`i parashtruar sipas disa mënyrave komunikuese të caktuara. Ky kurs ligjëratah ka për qëllim të shpjegojë se si mund të kryhet një studim që mbështetet në metodën e duhur, duke dhënë kështu ndihmesë teoriko-kritike-analitike rreth dobisë së të marrit me studime, por dhe do të udhëzojë e ndihmojë lidhur me mënyrën se si mund të punohet një punim konkret. Thënë më shkurt, programi përmban sasi të mjaftueshme të materialeve teorike, për t`i dhënë rëndësi të veçantë punës praktike, nga e cila krijohet një bazament i qëndrueshëm për të ndërtuar intelektualisht. Me përfundimin e kësaj lënde studentët do të jetë në gjendje të: • Kuptojnë parimet dhe teknikat e të shkruarit të një punimi hulumtues shkencor; • Kuptojnë strukturën e një punimi diplome• Vlerësojnë projektet kërkimore në mënyrë kritike; • Të jenë në gjendje për të zgjedhur metodat e duhura për mbledhjen e të dhënave; • Kuptojnë çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e pyetësorëve dhe intervistimit; • Kuptojnë çështjet që kanë të bëjnë me raste studimore dhe fokus grupe					
Objektivat		Objektivi i lendes Mrotda Kerkimore eshte te gjej pergjigjet per pyetjet nepermjet aplikimeve te metodave shkencore te cilat jane te percaktuara qarte. Qellimi kryesor i Metodave Kerkimore eshte gjetja e se vertetes e cila eshte e fshehur dhe e pazbuluar.					
Konceptet Kryesore		1. -Vlerësimi Kritik 2.-Plagjiatura 3.-Modelet e hulumtimit					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	- Ç'është kërkimi shkencor? Karakteristikat e kërkimit shkencor. Cilësia në kërkime shkencore. (F. 6-16) Në këtë leksion shtjellohen më në detaj natyra dhe objektivat e kërkimit në edukim. si dhe roli i kërkimit shkencor në edukim .Në këtë kapitull do të trajtohen çështje të tilla si Metodat shkencore kërkimore (analiza e sinteza, induksioni dhe deduksioni, abstraksioni dhe konkretizimi, gjeneralizimi dhe specializimi, metodat e klasifikimit, metoda krahasimore, metoda historike, metodat statistikore, metodat kibernetike, metodat matematikore, metodat e vëzhgimit e tjerë). Klasifikimi i veprave shkencore, veprave profesionale dhe i veprave shkencore-profesionale; Procesi kërkimor shkencor. në këtë temë të leksionit gjithashtu trajtohet dallimi midis kërkimit cilësor dhe sasior dhe metodave të përdorura për secilin formë kërkimi..Leksioni trajton në detaje komponentë të tillë si kerkimi shkencor si domosdoshmeri ,problemet e jetes se perditeshme ,permiresimi i cilesise se jetes ,kerkimi si pjese e shkolles dhe edukimit si dhe kerkimi si pjese e jetes ne vazhdimesi.Leksioni gjithashtu bën një hyrjen në konceptin e metodologjisë.						

2	Dijet, teoritë paradigmë dhe këndvështrimet. (f. 42-53) Në këtë leksion trajtohen çështje të tilla si natyra e subjektit të kërkimit shkencor në shkencat sociale. Shkencat sociale vendos theks te konsiderueshem mbi zhvillimin dhe perdorimin e teorisë .Shkencat sociale gjenerojne te dhena ne kushte te kontrolluara per te testuar teoritë e tyre – lidhje te supozuara mes forcave fizike, te verifikuara permes skemave eksperimentale dhe gjuenerimit te te dhenave..Teoritë ne shkencen sociale tentojne te adresojne fenomene me komplekse te motivimit dhe sjelljes individuale dhe te grupeve, dhe efektet mbi institucionet sociale. (Shpesh nuk mund te observohet ose matet ne menyre sasiore direkt ne kushte te kontrolluara. Dija (Si ne e “dime” ate ate qe dime?) • Dija pozitive dhe Normative (Johnson, 1986) • Dija private dhe publike (Larrabee, 1964) Dija pozitive dhe Normative • Pozitive – Dija mbi kushtet, ose gjerat qe jane te vrojtueshme ose te matshme ne menyre direkte. • Normative – dija mbi vlerat – Dije preskriptive – cfare duhet (ose nuk duhet) bere per te zgjidhur problemin. Nga vete natyra e saj, permban gjykim
3	Natyrë e të dhënave. (88-91) Në këtë leksion trajtohen çështje të tilla si karakteristikat e të dhënave,përdorimi i të dhënave si përfaqësim i relitetit shoqëror.Metodologjite, metodat e mbledhjes se te dhenave, shqyrtimi i burimeve te ndryshme te literatures • Puna me literaturen fillon paralelisht me te menduarit per temen • Marrjen e vendimeve gjate rruges • Metoden e mbledhjes se te dhenave • Kryerjen e analizes • Lexim per te marre informacion rreth temes • Kerkim i hollesishem • Lexim dhe vleresim i informacioneve ne dispozicion • Strukturim dhe krijim i nje pasqyre perfundimtare te literatures • Pasqyra e literatures pjese e pergatitjes per hulumtim • Analize e deritanishme e fushes
4	Pyetjet e kërkimit shkencor, 150-200 Në këtë leksion trajtohen çështje të tilla si hipotezat, përkufizimet operative të kërkimit shkencor.Leksioni gjithashtu trajton çështje të tilla si Pyetjet e hulumtimit • Zbuluese • Pershkruese • Spjeguese • Vleresuese Në të trajtohen me studentët edhe Hipotezat – pohim i testueshem i nje marredhenieje ose marredheniet midis dy a me shume koncepteve., Asosiacioni – bindja se midis dy koncepteve ekziston nje lidhje, por jo domosdoshmerisht se ajo eshte shkakesore, Testimi pilot – nje prove ose mundesi per te vene ne prove metoden e mbledhjes se te dhenave.
5	Planifikimi i një projekti kërkimi shkencor. Përkufizimi, aspekte praktike Planifikimi dhe hartimi i punës studimore dhe kërkimore në edukim. Hartimi i nje platforme studimore (F 56-58,) Në leksion parashtrohen hapat për planifikimin dhe pergatitjen e një punimi duke përfshirë – Planifikimi i një studimi apo projekti. – Pasqyra e literaturës. – Modelet e hulumtimit. – Ngjashmëritë dhe dallimet. – Niveli dhe njësia e studimit. – Kontrolli i cilësisë së kërkimit. Leksioni gjithashtu ka për qëllim të aftësojë studentët në hartimin e një propozimi itë projektit te kerkimit – Elementet e Propozimit te kerkimit – Vleresimi i projektit te kerkimit – Rendesia e fleksibilitetit – Financimi i kerkimit – Rendesia e te Shkruarit – Udhëzime dhe Keshilla mbi te shkruarit Leksioni gjithashtu hedh dritë mbi çështje praktike të planifikimit dhe menaxhimit të një projekti – Qellimi, arsyeja e realizimit te hulumtimit – E kerkon programi mesimor – Mbajtja e qendrimit – Kerkim fondesh
6	Vlerësimi kritik i literaturës. Kërkimi i literaturës. (70-80) Leksioni gjithashtu hedh dritë mbi aspekte praktike të shqyrtimit të literaturës. Procesi i shqyrtimit të literaturës. Hartimi i nje platforme studimore ,përgatitja e hulumtimit ,planifikimi i një studimi apo projekti,pasqyra e literaturës, modelet e hulumtimit, ngjashmëritë dhe dallimet, niveli dhe njësia e studimit, kontrolli i cilësisë së kërkimit.
7	Modelet e hulumtimit. Modeli cilësor dhe modeli sasior. Niveli dhe njësia e kërkimit shkencor. Strategjitë e kërkimit shkencor. (F 110-130) Leksioni hedh dritë mbi mjetet e kërkimit mjetet e përdorura për studime Llojet e kerkimit • Debati sasiore/cilesore. • Mjetet e kerkimit. • Hulumtimi juaj. • Struktura e kerkimit. • Shprehitë e mbledhjes së të dhënave. Debati sasiore / cilesore • Ndarja sasiore / cilesore • Fusha e zbatimit • Shkencat ekzakte • Shkencat shoqerore • Zhvillimi i matematikes, kompiuteri Arsye per te perdorur kerkimet e perziera • Informacion perdoret se bashku dhe hulumtimi del me i mire i Ç'fare lloj te dhenash duhen? • Per kerkime sasiore - disiplinat • Per kerkime cilesore - disiplinat Perdorimi i kerkimit cilesor • Perpara kerkimit sasior • Krahas kerkimit sasior • Pas kerkimit sasior • Trekendezimi • Pyetje e njejte – Te dhena te ndryshme • Pyetje e njejte - Burime te ndryshme • Intervista – E strukturuar – Gjysem e strukturuar – E pa strukturuar • Anketimi • Vezhgim, kqyrje, vrojtim • Sondazhi • Grup fokusimi • Mbledhje dokumentash • Mbledhje te dhenash – Paresore – Dytesore • Eksperimenti
8	Provim gjysmë-final

9	Matja shumëdimensionale. Pyetësorët, shkallët, testet e matjes. Hartim pyetësorësh dhe intervistash. (F 200-230) Në leksion trajtohen gjerësisht për studentët çështje të tilla si Mbledhja e të dhënave. Pyetësorët, intervistat gjysëm të strukturuar. Gjithashtu në këtë leksion detajohen Matjet shumëdimensionale, Pyetësoret dhe përdorimi i tyre. • Përdorimi i pyetësoreve në studimet shoqërore e juridike. • Etika në përdorim. • Intervistat gjysëm të strukturuar. • Kushtet dhe kontekstet. • Zgjedhja e kampionit dhe respektimi i etikës. • Vrojtimi, llojet dhe ndikimi i vëzhguesit. • I strukturuar • Metoda apo menyra e mbledhjes se të dhënave, me pyetje të njëjta për çdo pjesëtar, me një grup të përbashkët përgjigjesh për çdo pyetje Përdorimi i pyetësoreve për studime shoqërore • Mbledhje opinionesh, qendrimesh, njohurite e vlerat e qytetareve • Karakteristikat • Përvojat e qytetareve • Sondazhi i krimit – UK çdo vit • 40.000 persona mbi 16 vjeç • Zgjedhje e rastësishme • Zgjedhja e grupit Çështje etike në pyetësor • Anonime • Nuk vendosen emra dhe karakteristika dalluese • Kur vleresohen mosha e karakteristika të ndryshme duhet të ketë madhësi të pershtatshme për të bërë krahasimin • Udhëzime të qarta • Vetepërjashtimi (aftesia për të lexuar) • Sqarime të qarta • Anketimi për çështje sensitive Hartimi i pyetësorit Te dhënat ,Llojet e përgjigjeve ,Llojet e pyetjeve ,Sugjerime për pyetësoret ,Renditja e pyetjeve ,Niveli i lartë i përgjigjeve • Pyetësor balle për balle • Intervista telefonike • Vetepërjashtimi Kontakti Cilesia Vlefshmeria e konvergencës ,Vlefshmeria konstruktive Te mirat e pyetësorit • Mbledhje efektive të dhënash • Mbledhje në të njëjtën mënyrë për të tjerë • Pyetjet dhe gama përcaktohen nga hulumtuesi • Kampioni dhe popullata Anet e dobëta • Qasje e kufizuar • Mundësi e kufizuar për përgjigje sipas të pyeturve • Janë me të frutshme në kampione të mëdha • Mund të përjashtojnë grupe të caktuara Intervistat gjysëm të strukturuar • Metode e mbledhjes se të dhënave që zakonisht: – Lehtëson komunikimin e drejtëpërdrejtë midis njerezve ose balle për balle ose në distancë nëpërmjet telefonit ose internetit – I lejon intervistuesit të marrë informacion, ndjenja dhe opinione nga i intervistuari duke përdorur pyetje dhe dialog ndërvetësor Intervista të strukturuar • Te standartizuara • Intervista anketimi • Te njëjtat pyetje, në të njëjtën mënyrë, jepen zgjedhje për përgjigjet Intervista gjysme të strukturuar • Te thëlluara • Anketimi • Në grup • Te njëjtat pyetje për intervistat, paraqiten në rend, pjesëmarrësit përgjigjen me fjalet e veta Intervista të pastrukturuar • Te thëlluara • Në grup • Rrefyese • Përqendrim në fusha të gjera • Flasin për temën e hulumtimit në mënyrën e tyre Intervista me pjesëmarrje • Hulumtuesi kontrollon intervistën • Intervista informuese • Pjesëmarrësi kontrollon intervistën dhe tregon historinë sipas mënyrës së vet Hulumtimi eksplorues ,Testim pilot,Hulumtim spjegues ,Vlerësimi ,Udhëzuesi
10	Grupet e fokusit. 230-262 Në këtë leksion trajtohen çështje të tilla si Vrojtimi. Burimet dytësore të të dhënave. Grupet e fokusit Fokus grupi Konteksti i grupit të fokusit Vrojtimi • Menyra baze e mbledhjes se të dhënave • Përdorim i shqisave • Shikimi i dukurive dhe regjistrimi se si ngjarjet ndodhin Vrojtje dhe thjeshtë Vrojtje me pjesëmarrje • Hulumtuesi merr të dhëna nga grupi i njerezve duke qenë pjesë e tyre Problematika e vrojtimeve • Kampionimi • Regjistrimi i të dhënave • Vlefshmeria • Kompleksiteti
11	Analiza e të dhënave. Tiparet e analizës. Analiza statistikore 185-200 Leksioni trajton çështje të tilla si Mbledhje e të dhënave 2. Përpunimi dhe prezantimi i të dhënave Karakterizimi i të dhënave. Ai hedh më shumë dritë mbi Statistikën si shkencë e të dhënave që përfshin mbledhjen , klasifikimin, organizimin, analizimin dhe interpretimin e informatave numerike me qëllim të marrjes së vendimeve efektive
12	Analiza tematike. (200-220) Në këtë leksion trajtohen çështje të tilla si puna me të dhëna cilësore, analiza e rrëfimeve, analiza e ligjëritimit, analiza e përmbajtjes., Metodot e John Stewart Mill Vezhgimi, induksioni, verifikimi Analiza dhe Sintetizimi Zberthim – Bashkim Ndarja e objektit të studimit në pjesë të përberëse Bashkim të elementeve të studimit Uniteti i tyre
13	Shkrimi akademik, procesi i të shkruarit. Fusha e veprimit dhe karakteristikat e përdorimit. fq 60-70 Shkrimi akademik - kërkim i strukturuar i shkruar nga një apo disa studentë për të tjerët, i cili adreson një apo disa çështje me interes nga një fushë e caktuar, për çdokënd që kërkon informacione faktike dhe punim dhe argumentim të një studenti, studiuesi të një kolegji apo universiteti. Shkrim akademik është përdorur edhe në punimet apo botimet që janë përgatitur nga mësuesi dhe studiuesit duke i paraqitur në konferenca, kongrese apo seminare. Gjithashtu, shkrimi akademik është përdorur në formë të ndryshme. Në një përkufizim shumë më të gjerë shkrimit akademik mund të përfshijë çdo detyrë me shkrim të dhënë në një ambient akademik. Shkrimi akademik është një format i shpjegues dhe argumentues prozë argumentuese e përdorur nga studentët e universitetit dhe studiues të ndryshëm për të përcjellë përmes një formati të shkruar informacion në lidhje me një çështje të veçantë. Në përgjithësi, shkrim akademik pritet të jetë i saktë, gjysmë-formale, i papërcaktuar, dhe objektiv dhe për këtë duhet të respektohen hapat kërkimore që janë burimi i gjetjeve të një teze kërkimore të paraqitur përmes një shkrimi akademik.

14	Planifikimi dhe struktura e shkrimit akademik. Mënyra e të shkruarit 60-70 Planifikimi • Renditja paraprake, krijim, hartim, formulim • Planifikim i detajuar • Pjesë thelbësore e strategjise së hulumtimit. • Nuk punohet pa plan. • Te menduarit për projektin, hulumtimin ka shumë rendesi. • Përgjate rruges behen edhe modifikime • Planifikimi i mire shkurton kohe • Me mire te shpenzohet kohe ne planifikim se sa te humbitet kohe per plotesimin e hapsirave te lena bosh nga planifikimi i keq Planifikimi - sistem individual • Harta mendore, diagrama, lista, shenime • Plan qe na drejton • Ne shkrimin e variantit perfundimtar • Realizimi i projektit ne boten reale • Projektet ndryshojne nga detajet, procesi i planifikimit i njejte Dy procese
15	Sistemi i referencave. Plagjiatura. Etika Etika dhe kerkimi shkencor (F 70 -85) Në leksion trajtohen tematika të tilla si Vlerat dhe etika sociale e kërkimit edukativ ,Etika – vlerat morale dhe shoqërore të hulumtimit shoqëror. Etika e hulumtimit shkencor ka të bëjë me krijimin e marrëdhënieve respekti reciprok në të mirë të tërë paleve ku pjesëmarrësit janë të kenaqur të përgjigjen me sinjoret ku merren rezultate të vlefshme dhe komuniteti e konsideron përfundimet konstruktive. Dilema etike në kerkimin shkencor • Njohja e njeriut nuk është gjithmone neutrale në atë që sjell, ajo gjithashtu jep pushtet ndaj njeriut • Dilemat lidhur me faktin • Përdorimi i rezultateve të kerkimit shkencor • Respektimi i standarteve • Presioni ndaj shkencetareve • Justifikimi i veprimeve Kërkesat etike të kerkimit • Marrëdhëniet me ata që përfshihen në kerkim • Ndërshtetëria • Objektiviteti • Integriteti Kodi i etikës i studenteve dhe kerkimi shkencor Udhezimet etike Përqimi i informuar Risku Mbrojtja nga lëndimi (pjesëmarrësi) • Lëndimi fizik – eksperimentet, vendi • Lëndimi psikologjik – tema delikate, • Pasoja të tjera • Humbja e punës së pjesëmarrësit • Informacioni personal – konfidencialiteti • Kush do të lexojë raportin • Nëse pjesëmarrësi tregon se ka bërë diçka të paligjshme. Risku Grupet e cënueshme Mbrojtja nga lëndimi (hulumtuesi)
16	Provimi final
Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Bob Matthews, Liz Ross (CDE 2010). Metodën e hulumtimit - Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane • Jill Lewis, Studimi akademik. CDE, 2005, Tiranë • Umberto Eco. Si shkruhet një punim diplome. Dituria. 2006. Tiranë
Referenca të tjera	• Dawson, C. (2007) A practical guide to research methods. Howto books. Oxford • Dawson, C. (2006) The mature student's study guide. Howto books.Oxford, UK
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studenti do të jetë në gjendje të analizojë procesin e mbledhjes së të dhënave në shkencat shoqërore dhe në shkencat kompjuterike
2	Studenti do të jetë në gjendje të diskutojë mbi rëndësinë e etikës hulumtuese dhe të shpjegojë konceptin e etikës
3	Studenti do të jetë në gjendje të identifikojë dhe analizojë konceptet dhe procedurat e kampionimit, analizimit dhe raportimit
4	Studenti do të jetë në gjendje të shkruajë, lexojë dhe shpjegojë artikuj kerkimor në disiplinen e tyre akademike
5	Studenti do të jetë në gjendje të shpjegojë konceptet dhe çështjet kryesore të kerkimit

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	14	14
Provimi final	1	18	18
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00